

RAPORT
nga debati publik në lidhje me Projekt-Vendimin për shpalljen e një pjese të
Vodno-s si zonë e mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur

Në përputhje me nenin 95 paragrafi (2) nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e RM" Nr. 67 / 04,14 / 06, 84/07, 35/10, 47/11, 148/11, 59 / 12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15, 39/16 dhe 113/18) dhe Projekt-Procesverbali nga Seanca e Njëzetënjëtë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Veriore (mbajtur më 17.11. 2020), Ministria e Mjedisit Jelsor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit më 03.02.2021 mbajti një debat publik online në lidhje me Projekt-Vendimin për shpalljen e një pjese të Vodno-s si zonë e mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur.

Debati publik u organizua me qëllim që palët e interesuara të japin sugjerimet, rekomandimet dhe vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt-Vendimin për shpalljen e një pjese të Vodno-s si zonë e mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur.

Debatin publik e hapi dhe e moderoi një moderator i pavarur, i cili e prezantoi rendin ditor.

Pastaj vijoi edhe fjalimi nga Drejtori i Drejtorisë së Mjedisit në MMJPH, i cili përmendii aktivitetet dhe progresin e MMJPH-së në fushën e mbrojtjes së natyrës me një aspekt të veçantë të zonave të mbrojtura dhe aktivitetet për shpalljen e një pjese të Vodno-s si zonë e mbrojtur.

Fjalë përshëndetëse gjithashtu kishte edhe Shefi i Kabinetit të Kryetarit të Shkupit, i cili theksoi aktivitetet e Qytetit që kanë lidhje me Vodnon.

Një përfaqësues i ekipit të ekspertëve që përgatitii Studimin për vlerësimin e zonës së mbrojtur park-pyll Vodno (i cili është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe është baza për përgatitjen e Projekt-Vendimit për shpalljen e Vodno-s si një zonë e mbrojtur), u prezantuan vlerat natyrore, kategoria e mbrojtjes, kufijtë e propozuar dhe zonat e propozuara të zonës së mbrojtur të ardhshme Zona e mbrojtur - Vodno.

Përfaqësuesi i MMJPH-së mbajti një prezantim mbi procedurën për shpalljen e Vodno-s si zonë të mbrojtur dhe strukturën e Projekt-vendimit për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë të mbrojtur në kategorinë V - zonë e mbrojtur.

Debati publik u vlerësua si shumë i suksesshëm, me çka u zhvillua edhe një diskutim i gjërë në mes publikut profesionist, përfaqësuesve të MMJPH-së, OJQ-ve dhe institucioneve të tjera në lidhje me Projekt-Vendimin për shpalljen e një pjese të Vodno-s

si zonë e mbrojtur në kategorinë V-Zonë e Mbrojtur duke siguruar kështu një proces transparent të përfshirjes së publikut në përgatitjen e aktit të shpalljes.

Përfaqësuesit nga Fakulteti i Pylltarisë dhe OJQ "E dua Vodnon" kishin vërejtje në lidhje me Projekt-vendimin për shpalljen e një pjese të Vodno-s si një zonë e mbrojtur në kategorinë V- zonë e mbrojtur, me një kërkesë për të ndaluar procesin e miratimit të tij nga Qeveria për faktin se duhet të miratohet një ligj i veçantë kornizë për Vodnon, i cili do të rregullojë çështjet e përrrenjve, erozionit, menaxhimit me pyjet, urbanizimit, etj.

Nga ana e MMJPH-së u theksua që rishpallja e një pjese të malit Vodno paraqet një detyrim nga legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e natyrës, dhe atë nga: Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Plani Hapësinor i vendit, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës me Planin e Veprimit (2017-2027), Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin me një Plan Veprimi për periudhën (2018-2023) dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi pranueshmërinë e propozimit për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 275/2020). Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, kategoria V - zonë e mbrojtur shpallet me një Vendim të Qeverisë.

Gjithashtu janë dhënë informacione se iniciativa për shpalljen e Vodno-s si zonë e mbrojtur ishte iniciuar nga ana e Qytetit të Shkupit, i cili dorëzoi deri te MMJPH një Propozim për shpalljen e Vodno-s një zonë të mbrojtur në kategorinë Zonë e Mbrojtur së bashku me një Studim për vlerësimin e zonës së mbrojtur park-pyll Vodno. Dokumenti themelor për përgatitjen e Projekt-vendimit është Studimi, i përgatitur nga një ekip i ekspertëve dhe i njëjti është pranuar nga Qyteti i Shkupit. Në të njëjtën kohë, iniciativa për shpalljen e një pjese të Vodno-s është pranuar nga Qeveria e RMV-së, e cila miratoi Vendimin mbi pranueshmërinë e propozimit për shpalljen e një pjese të malit Vodno një zonë të mbrojtur (Gazeta Zyrtare e RMS-së nr. 275/2020). Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, MMJPH përgatiti një Projekt-vendim për shpalljen e një pjese të Vodno-s një zonë të mbrojtur në kategorinë e V – zonë e mbrojtur. Me këtë Projekt-Vendim propozohet qyteti i Shkupit si një subjekt kompetent për menaxhimin me zonën e mbrojtur - Vodno.

Përfaqësuesi i Agjencisë për Planifikim Hapësinor theksoi se ata mbështetën iniciativën e profesorëve nga Fakulteti i Pylltarisë për të miratuar një ligj të veçantë për Vodnon.

Nga përfaqësuesi i MMJPH-së kemi përgjigje se Agjencia për Planifikim Hapësinor tashmë ka dhënë një mendim pozitiv mbi vendimin mbi pranueshmërinë dhe përgatitjen e një projekt-vendimi për shpalljen e një pjese të Vodno-s si zonë e mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur.

Një përfaqësues i OJQ-së TRIFOR theksoi se planifikimi hapësinor në Vendimin për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur në kategorinë V – zonë e mbrojtur është bërë vetëm nga aspekti i natyrës, dhe nuk janë marrur parasysh edhe procese të tjera si pylltaria.

Përfaqësuesi nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) theksoi se nuk respektohet Ligji për Natyrën para miratimit të këtij Projekt-Vendimi për shpalljen e një pjese të Vodno-s si zonë e mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur dhe theksoi se e mbështet këtë iniciativë për një ligj të ri të posaçëm për Vodnon.

Projekt-vendimi për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur në kategorinë V- zonë e mbrojtur u përgatit në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Gjithashtu u theksua se nuk ka asnjë akt tjetër juridik në nivel kombëtar për shpalljen e zonave të mbrojtura.

Për më tepër, ekipi i ekspertëve që përgatiti studimin shpjegoi se në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, zbatohet edhe Ligji për Mjedisin Jetësor dhe dispozitat e ligjeve të tjera në lidhje me mbrojtjen e natyrës. Lidhur me vërejtjet e bëra në debatin publik për përfshirjen e erozionit në Projekt-vendimin për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur në kategorinë V – zone e mbrojtur, MMJPH theksoi se kjo çështje rregullohet në përputhje me Ligjin për Ujërat. Sipas këtij ligji, Këshilli Komunal dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe ndërmarrjet e ujit janë të detyruar që në territorin nën kompetencat e tyre të përcaktojnë kufijtë e zonës erozive dhe zonës së rrezikuar nga erozioni dhe të përcaktojnë masat dhe punët për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rregullimi i përrenjve, bazuar në dokumentacionin teknik, i cili duhet të jetë pjesë e Planit të Menaxhimit të zonës së mbrojtur të ardhshme që do të menaxhohet nga Qyteti i Shkupit.

Një gazetar nga Kanal 5 pyeti se çfarë do të ndodhë me urbanizimin e Vodno-s me propozimin e deritanishëm, dhe nëse do të merren të gjitha komentet.

MMJPH theksoi se aktivitetet mbi çështjet e erozionit dhe urbanizimit do të përfshihen në Planin e Menaxhimit me Zonën e Mbrojtur - Vodno. Plani është përgatitur në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës nga subjekti për menaxhimin me zonën e mbrojtur, në këtë rast Qyteti i Shkupit. Plani përmban një sërë programesh për të promovuar mbrojtjen, ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe për të siguruar menaxhim të duhur dhe më të mirë me zonën e mbrojtur. Aktivitetet për erozionin do të përfshihen në këtë plan. Plani do të miratohet në një mënyrë transparente dhe duke mbajtur një debat publik me të gjithë palët e interesuara, pas miratimit të Vendimit për shpalljen e një pjese të malit Vodno si një zonë e mbrojtur në kategorinë V- yonë e mbrojtur.

Në fund të debatit publik, pjesëmarrësit u informuan se paraqitja e komenteve, vërejtjeve dhe sugjerimeve në lidhje me Projekt-Vendimin për shpalljen e një pjese të Vodno-s si zonë e mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur do të jetë e hapur deri më 13 shkurt dhe të njëjtat janë të mirëpritura.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
04.02.2021

Lista e vërejtjeve dhe mendimeve të paraqitura nga publiku

Nr.	Individët nga të cilët janë dorëzuar sugjerime, komente dhe vërejtje	Vërejtje/Propozim	Pranimi i propozimit
1.	Shoqata "E dua Vodnon" dhe 37 shoqata të qytetarëve dhe individëve	<p>-Të ndalohet Projekt-Vendimi për shpalljen e një pjese të Mali Vodno për zon[të mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur dhe qasja e menjëhershme në përgatitjen e një Ligji të veçantë për Vodnon me krijimin e një komisioni të ekspertëve ndërsektorial.</p>	<p>Si një detyrim nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) duhet të kryejë rivlerësimin e të gjitha zonave të mbrojtura dhe të përgatisë akte të reja për shpallje.</p> <p>Shpallja e një pjese të malit Vodno paraqet një detyrim të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e natyrës: Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Plani Hapësinor i Shtetit, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës me Planin e Veprimit (2017-2027), Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit me Planin e Veprimit për periudhën (2018-2023) dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi pranueshmërinë e propozimit për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 275/2020).</p> <p>Iniciativa për shpalljen e Vodno-s si zonë e mbrojtur u iniciua nga Qyteti i Shkupit, i cili dorëzoi në MMJPH një Propozim për shpalljen e Vodno-s një zonë të mbrojtur në</p>

			<p>kategorinë Zonë e Mbrojtur së bashku me një Studim për vlerësimin e zonës së mbrojtur park-pyll Vodno. Dokumenti themelor për përgatitjen e Projekt-vendimit është Studimi, i përgatitur nga ekipi i ekspertëve dhe i njëjti është pranuar nga Qyteti i Shkupit. Propozimi për shpalljen e zonës së mbrojtur park-pyll Vodno si zonë e mbrojtur u miratua në seancën e 50-të të Këshillit të Qytetit të Shkupit, të mbajtur më 03.04.2020.</p> <p>Në kuadër të procedurës për shpalljen e Vodno-s për zonë të mbrojtur, MMJPH paraqiti kërkesa në 41 institucione për mendime në lidhje me informacionin mbi nevojën për të shpallur një pjesë të Vodno-s një zonë të mbrojtur në kategorinë – zone e mbrojtur. MMJPH mori 36 mendime pozitive nga institucionet me mbështetjen për shpalljen e Vodno-s për, zonë të mbrojtur, ndërsa vetëm një mendim negative, ndërsa 4 institucionet edhe përkatësisht urgjencës nuk paraqitën mendime.</p> <p>Në lidhje me Vodnon, mendime pozitive u morën nga institucionet më të rëndësishme shkencore dhe profesionale për mbrojtjen e natyrës / biodiversitetin dhe ato janë: ASHAM, Fakulteti i shkencave matematike-natyrore, Instituti i Biologjisë dhe Instituti i Gjeografisë, Muzeu i Shkencave Natyrore i Maqedonisë, Instituti Hidrobiologjik Ohër, dhe Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e Natyrës etj. MMJPH në kuadër të procedurës për shpalljen e Vodno-s punon në mënyrë transparente dhe informon të gjitha palët e interesuara.</p> <p>Në këtë drejtim, u zhvillua një debat publik, i</p>
--	--	--	--

		<p>-të fillohet qasja për punimin e lex specialis për Vodnon, ku do të përgatitet zonimi i duhur në përputhje me përparësinë e tokës dhe të gjitha ligjet në fuqi për Vodnon, siç është Ligji për Ujërat, Ligji për Menaxhimin e Krizave, Ligji për mbrojtjen dhe shpëtimin, Ligji për Zjarrfikjen, Ligji për pyjet, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, dhe kështu të përcaktohet se ku është e ndaluar dhe ku çfarë lejohet</p>	<p>cili u vlerësua si shumë i suksesshëm, gjatë të cilit u zhvillua një diskutim i gjerë midis publikut profesionist, përfaqësuesve të MMJPH-së, OJQ-ve dhe institucioneve të tjera në lidhje me Projekt-vendimin për shpalljen e një pjese të Vodno-s si një zonë e mbrojtur në kategorinë V- Zonë e mbrojtur dhe në të njëjtën kohë u siguroa një proces transparent i përfshirjes së publikut në përgatitjen e aktit të shpalljes.</p> <p>Projekt-vendimi për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur në kategorinë V – zone e mbrojtur është përpunuar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Në sistemin juridik të shtetit nuk ekziston një akt tjetër juridik për shpalljen e zonave të mbrojtura, përveç Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës. Bazuar në këtë ligj, shpallen të gjitha zonat e mbrojtura, përfshirë Vodnon. Neni 1 paragrafi 4 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës përcakton se "Dispozitat e ligjeve të tjera në lidhje me mbrojtjen e natyrës zbatohen gjithashtu për mbrojtjen e natyrës". Kështu, në aktin e shpalljes, detyrimet për përcaktimin e kufijve të zonës së rrezikuar nga erozioni dhe zonat erozive në përputhje me Ligjin për Ujërat janë referuar për krijimin e tyre brenda zonës së mbrojtur të ardhshme. Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, subjektet e ngarkuara për menaxhim me zonën e mbrojtur, menaxhojnë të gjithë zonën e mbrojtur në një mënyrë të integruar bazuar në të gjitha rregulloret përkatëse.</p>
--	--	--	--

		<p>-të përpunohet një Plan Menaxhimi ku do të përdoren të gjitha punët e zbatueshme nga shumica e ligjeve ku përpunohen plane të tilla, si p.sh. Plani i menaxhimit me pellgun lumor, Plani i menaxhimit me përmytjet, Plani i menaxhimit me zonën e mbrojtur, Plani i kultivimit dhe mbrojtjes së pyjeve, Plani i menaxhimit të peizazhit kulturor dhe do të përcaktohet se cili institucion është më i përshtatshmi për ta zbatuar atë</p>	<p>Për më tepër, përveç planit të menaxhimit që përcakton masat e mbrojtjes, si dhe aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara, parashikohet miratimi i një Plani Hapësinor për zonën.</p> <p>Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, subjekti për menaxhimin e zonës së mbrojtur përgatit një Plan të Menaxhimit me Zonën e Mbrojtur, në këtë rast do të jetë Qyteti i Shkupit. Përmbajtja e planeve për menaxhimin me zonat e mbrojtura përshkruhet në nenin 98 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe aktit nënligjor - Rregullore për përmbajtjen e planeve për menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe programet vjetore për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare e RM nr. 26/12). Sipas rregullores përkatëse, midis elementeve të tjera, përcaktohet se masat mbrojtëse janë të përfshira për mbrojtjen e peizazhit, diversitetin gjeologjik dhe biologjik, trashëgiminë kulturore, mbrojtjen e zonave karakteristike, si dhe një sistem masash dhe veprimtarish për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera natyrore. Çështjet në lidhje me pyjet, përmytjet, mbrojtjen nga erozioni dhe përrenjtë do të trajtohen në veprimet nga programet e Planit të Menaxhimit.</p>
L	Prof. Dr Ivan Blinkov, Universiteti “ Shën Kirili dhe Metodi “ Shkup,	-Projekt-propozimi duhet të pushojë.	Si një detyrim nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, MMJPH duhet të kryejë rivlerësimin e të gjitha zonave të mbrojtura dhe të

	<p>Fakulteti i Pylltarisë, Arkitekturës së Peizazhit dhe Eko-Inxhinierisë “Hans Em”</p>	<p>përgatisë akte të reja për shpalljen. Shpallja e një pjese të malit Vodno paraqet një detyrim nga legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e natyrës, dhe atë nga: Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Plani Hapësinor i vendit, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës me Planin e Veprimit (2017-2027), Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit me Planin e Veprimit për periudhën (2018-2023) dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi pranueshmërinë e propozimit për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 275/2020). Iniciativa për shpalljen e Vodno-s si zonë e mbrojtur u iniciua nga Qyteti i Shkupit, i cili dorëzoi në MMJPH Propozimin për shpalljen e Vodno-s një zonë të mbrojtur në kategorinë Zonë e Mbrojtur së bashku me një Studim për vlerësimin e zonës së mbrojtur park-pyll Vodno. Dokumenti themelor për përgatitjen e Projekt-vendimit është Studimi, i përgatitur nga ekipi i ekspertëve dhe i njëjti është pranuar nga Qyteti i Shkupit.</p> <p>Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, subjektet e ngarkuara për menaxhimin me zonën e mbrojtur, menaxhojnë në mënyrë integrale me të gjithë zonën e mbrojtur.</p> <p>Çështjet në lidhje me pyjet, përmytjet, mbrojtjen nga erozioni dhe përrenjtë do të trajtohen në veprimet nga programet e Planit të Menaxhimit.</p> <p>Në përputhje me nenin 135 të Ligjit për Ujërat, Këshilli Komunal dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe ndërmarrjet e ujit nën</p>
--	---	--

		<p>- Përgatitja urgjente e një Ligji për Ujërat (ku do të vendosen dhe dispozita se sit ë bëhet Plani për menaxhimin me të gjitha aspektet), dhe në grupin ndërsektorial do të merrnin pjesë përfaqësues nga MMJPH (natyra, uji, planifikimi hapësinor), MBPEU (pyje, tokë bujqësore), MTV (për shkak të objekteve nën kompetencat e tyre), QMK i cili përfaqëson interesat e mbrojtjes në një nivel të caktuar, si dhe fatkeqësitë natyrore) etj.</p>	<p>kompetencat e tyre janë të detyruar në territor të përcaktojnë kufijtë e zonës erozive dhe zonës së rrezikuar nga erozioni dhe të përcaktojnë masat dhe punët për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rregullimi i përrenjve, bazuar në dokumentacionin teknik, i cili duhet të jetë pjesë e Planit të Menaxhimit me zonën e mbrojtur të ardhshme. Për këtë shkak është paraparë një detyrim për vendosjen e tyre para miratimit të Planit.</p> <p>Me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës rregullohet shpallja dhe përcaktohet kategoria e mbrojtjes. Neni 1 paragrafi 4 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës përcakton se "Dispozitat e ligjeve të tjera në lidhje me mbrojtjen e natyrës do të zbatohen gjithashtu për mbrojtjen e natyrës". Përmbajtja e planeve për menaxhimin me zonat e mbrojtura përshkruhet në nenin 98 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe aktit nënligjor - Rregullore për përmbajtjen e planeve për menaxhimin me zonat e mbrojtura dhe programet vjetore për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare e RM nr. 26/12).</p> <p>Në përputhje me nenin 103 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, miratohet një Plan Hapësinor me qëllim të rregullimit dhe përdorimit të hapësirës së kategorive të zonave të mbrojtura. Neni i përmendur përshkruan përmbajtjen e Planit Hapësinor të zonës së mbrojtur. Vendimi për shpalljen e Vodno-s si një zonë e mbrojtur parashikon</p>
--	--	--	---

		<p>- Të përgatitet një Plan Hapësinor për Vodnon (ku zonimi do të ishte në përputhje me kërkesat e të gjitha ligjeve me përparësi). Përderisa, për shkak të rëndësisë ekzistuese dhe metodologjisë për përgatitjen e një PH të ri të RMV-së, kjo është e vështirë, atëherë ai zonim i ardhshëm duhet të përfshihet si një detyrim në Planin e Menaxhimit).</p> <p>- Të përgatitet Plani për menaxhimin me Vodnon (plani në të cilin do të përfshihen të gjitha veprimet)</p>	<p>një detyrim për të miratuar një Plan Hapësinor.</p> <p>Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, nga një subjekt për menaxhimin me zonën e mbrojtur përgatitet një Plan i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur, në këtë rast do të jetë Qyteti i Shkupit.</p> <p>Përmbajtja e planeve për menaxhimin me zonat e mbrojtura përkrahur në nenin 98 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe aktit nënligjor - Rregullore për përmbajtjen e planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe programet vjetore për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare e RM nr. 26/12). Sipas rregullores përkatëse, midis elementeve të tjera, përcaktohet se masat mbrojtëse janë të përfshira për mbrojtjen e peizazhit, diversitetin gjeologjik dhe biologjik, trashëgiminë kulturore, mbrojtjen e zonave karakteristike, si dhe një sistem masash dhe veprimtarish për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësit e tjera natyrore.</p> <p>Çështjet lidhur me pyjet, përmytjet, nbrojtja nga erozioni dhe përrrenjtë do të përfshihen në programet 10-vjeçare të Planit të Menaxhimit.</p>
--	--	--	---

3.	MBPEU Departamenti i pylltarisë dhe gjuetisë	Nuk është vepruar në përputhje me Dispozitat e Nenit 95 paragrafi (1) nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Konkluzioni i Qeverisë së RMV-së (28.09.2011)	<p>Ligji bazë kornizë i cili rregullon çështjen nga fusha e mbrojtjes së natyrës është Ligji për Mbrojtjen e Natyrës.</p> <p>Në përputhje me këtë ligj, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është e detyruar ty kryejë rivlerësimin e zonave të mbrojtura, para ditës së fillimit të zbatimit të ligjit dhe të përgatisë akte të reja për shpallje. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e Natyrës dha një mendim pozitiv në lidhje me propozimin për shpalljen e zonës së mbrojtur Vodno dhe Projekt-vendimin për shpalljen e një pjese të malit Vodno zonë të mbrojtur të kategorisë V - Zonë e mbrojtur</p> <p>Konkluzioni i Qeverisë nga 28.09.2011 nuk është në përputhje me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e natyrës.</p> <p>Baza për shpalljen e zonave të mbrojtura janë Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës me Planin e Veprimit (2017-2027), Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin me Planin e Veprimit për periudhën (2018-2023) dhe Plani Hapësinor i vendit.</p> <p>Në procedurën për deklarimin e zonave të mbrojtura, MMJPH siguron mendimin e institucioneve përkatëse shkencore dhe profesionale, përfshirë të gjitha institucionet që në përputhje me ligjin emërojnë një anëtar të Këshillit Kombëtar të Natyrës. MMJPH paraqiti kërkesa në 41 institucione për mendime në lidhje me informacionin mbi nevojën për të shpallur një pjesë të Vodno-s një zonë të mbrojtur në kategorinë e zonës së mbrojtur. MMJPH mori 36 mendime pozitive</p>
----	--	---	--

			<p>nga institucionet me mbështetjen për shpalljen e Vodno-s si një zonë e mbrojtur. MMJPH në kuadër të procedurës për shpalljen e Vodno-s punon në mënyrë transparente dhe informon të gjitha palët e interesuara. Në këtë drejtim, u zhvillua një debat publik, i cili u vlerësua si shumë i suksesshëm, gjatë të cilit u zhvillua një diskutim i gjerë midis publikut profesionist, përfaqësuesve të MMJPH-së, OJQ-ve dhe institucioneve të tjera në lidhje me Projekt-vendimin për shpalljen e një pjese të Vodno-s si një zonë e mbrojtur në kategorinë e V-Zonë e mbrojtur dhe në të njëjtën kohë u siguroa një proces transparent i përfshirjes së publikut në përgatitjen e aktit të shpalljes.</p> <p>Përkrah kësaj, MMJPH kërkon mendime nga institucionet përkatëse shtetërore në lidhje me shpalljen e zonave të mbrojtura në dy procedura shtesë, gjegjësisht në nivelin e projekt-ligjit ose projekt-vendimit dhe propozim-ligjit ose propozim-vendimit, të cilat do të vendosen në ENER dhe Uebfaqen e MMJPH-së .</p>
--	--	--	---

4.	Shoqata e Qytetarëve - Trifor	<p>- Përfshirja e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e Natyrës</p> <p>-Nevojitet pranim më i detajuar i shërbimeve të ekosistemit sipas klasifikimeve ndërkombëtare (CICES)</p> <p>- Siguria e qytetarëve dhe vendbanimeve minimizohet në Studim</p> <p>-Kufiri i ri i propozuar mundëson lirimin e</p>	<p>Përgjigja është dhënë në pyetjen e mëparshme</p> <p>Ajo nuk është lëndë shqyrtimi. Projekt-vendimi është përgatitur në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Përmbajtja e Aktit për shpalljen e një zone të mbrojtur përcaktohet në nenin 92 paragrafi (7) të këtij ligji. MMJPH punon në identifikimin, hartëzimin dhe krijimin e shërbimeve të ekosistemit në nivel kombëtar përmes projektit: Programa për Mbrojtjen e Natyrës, Faza II, dhe Fakulteti i Pylltarisë, Arkitekturës së Peizazhit dhe Eko-Inxhinierisë Hans-EM është partner në Program.</p> <p>Studimi nuk është lëndë e shqyrtimit, pasi ajo u miratua nga Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe ishte konsultuar më parë. Projekt-vendimi u përgatit në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Përmbajtja e Aktit për shpalljen e një zone të mbrojtur përcaktohet në nenin 92 paragrafi (7) të këtij ligji. Siguria e qytetarëve është rregulluar me ligje të tjera. Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, përcaktohet se "Dispozitat e ligjeve të tjera që lidhen me mbrojtjen e natyrës vlejné edhe për mbrojtjen e natyrës".</p>
----	-------------------------------	---	---

		zonave që do të urbanizohen	Kjo çështje do të rregullohet me Planin e menaxhimit, i cili është në kompetencë të subjektit menaxhues, në këtë rast është Qyteti i Shkupit. Deri në miratimin e Planit të Menaxhimit, ndërtimi i ndërtesave të reja, zgjerimi dhe azhurnimi i atyre ekzistuese dhe zgjerimi i fushës urbane të vendbanimeve në territorin e zonës së mbrojtur - Vodno nuk lejohet.
5.	Një grup qytetarësh nga vendbanimi Trnodol, komuna Karposh	<p>Kufiri i parakohshëm mbrojtës (zona e përdorimit aktiv) të shtrihet në rreshtin e fundit të shtëpive mbi vendbanim</p> <p>Modifikimi i udhëzuesit të projekt-vendimit në pjesën e III: Regjimi i mbrojtjes, me vendosjen se çdo ndërtim i ri në zonën e përdorimit aktiv është i ndaluar (për shembull: strehim i ri ose ambiente të reja për përdorim turistik)</p> <p>Të shprehen arsyet mbi të cilat propozohet kufiri i zonës së mbrojtur në pjesën drejt vendbanimit Trnodol</p>	<p>Kufiri shkon sipas PPU-së, mbi pjesën e urbanizuar ose tokën urbane.</p> <p>Deri në miratimin e Planit të Menaxhimit, ndërtimi i ndërtesave të reja, zgjerimi dhe azhurnimi i atyre ekzistuese dhe zgjerimi i fushës urbane të vendbanimeve në territorin e zonës së mbrojtur - Vodno nuk lejohet.</p> <p>Këtu kufiri shkon sipas PPU-së, mbi pjesën e urbanizuar ose tokën urbane, sipas rekomandimeve dhe udhëzimeve nga Qyteti i Shkupit dhe Komuna e Karposhit, theksuar nga ekipi i ekspertëve për përgatitjen e Studimit për vlerësimin e zonës së mbrojtur park-pyll Vodno.</p>
6.	SHQ NATIVA Matka e Poshtme	- Ndalimi i Projekt-vendimit për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur në kategorinë V - Zonë e mbrojtur, si dhe për qasje urgjente në përgatitjen e një Ligji të veçantë për Vodnon, duke krijuar një komision të ekspertëve ndërsektorial.	Kjo pyetje është përgjigjur më lart.

		- Procedura për shpalljen e Vodno-s si një zonë e mbrojtur duhet të zhvillohet paralelisht me ligjin e shpallur për mbrojtjen e Matkës, sepse bëhet fjalë për një tërësi të pandashme, e cila nuk është rastësisht objekt i analizës në Studimin për vlerësimin e Matkës dhe Vodno-s si një zonë e mbrojtur e iniciuar nga UNDP	Procedura për shpalljen e Kanionit të Matkës si zonë e mbrojtur është duke vazhduar. Janë përgatitur dy studime të veçanta për vlerësimin e Vodno-s dhe Matkës, Këto janë dy procedura të ndryshme për shpalljen e zonave të mbrojtura të cilat udhëhiqen nga MMJPH në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, në përputhje me kategorinë e mbrojtjes. Funksionimi i ardhshëm i dy zonave të mbrojtura do të bëhet përmes bashkëpunimit dhe harmonizimit të ndërsjellë.
7.	Tome Velkovski Rr. Divizioni i 50-të, Nr. 26, Shkup	Projekt - Vendimi është i pasaktë dhe i paqartë dhe nga teksti i paraqitur dhe veçanërisht nga harta e bashkangjitur nuk është e mundur të përcaktohet qartë kufiri i saktë dhe preciz i zonës - së zonave të mbrojtura	Kufiri i propozuar i zonës dhe zonat e propozuara mund të kërkohen nga subjekti për menaxhim, gjegjësisht Qyteti i Shkupit në mënyrë që ato të shihen në më shumë detaje.
8.	dr.Hristijan Talevski hulumtues në lokalitetin arkeologjik Kullat e Markut - Vodno	Nëse kufijtë e propozuar për zonë të mbrojtur kalojnë nëpërmjet lokalitetit të trashëgimisë kulturore dhe nëse në kontekstin e përcaktimit të kufijve të zonave në kuadër të zonës së propozuar të mbrojtur, a është marrë parasysh trashëgimia tjetër kulturore materiale e vendosur në atë zonë?	Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, monumentet e kulturës në kuadër të zonave të mbrojtura gëzojnë mbrojtje të përshtatshme me statusin e tyre në përputhje me ligjin.
9.	Administrata Hidrometeorologjike (HMA)	-Anulimi i vendimit. - Në projekt-vendimin nuk përfshihen vërejtjet e mëparshme nga HMA. -Mbrojtja më e mirë e malit Vodno dhe hartimi i një ligji të veçantë për Vodnon.	Kjo pyetje është përgjigjur më lart. Projekt-vendimi u përgatit në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Përmbajtja e Aktit për shpalljen e një zone të mbrojtur përcaktohet në nenin 92 paragrafi (7) të këtij ligji.

			Kjo pyetje është përgjigjur më lart.
10.	Agjencia për Planifikim Hapësinor	<p>Mendim mbi Studimin e Vlerësimit dhe Propozim-vendimin për shpalljen e Vodno si zonë të mbrojtur në kategorinë e zonës së mbrojtur.</p> <p>Mbrojtje më e mirë e Vodno-s në përputhje me një ligj të ri të veçantë për Vodnon, Planin Hapësinor dhe Planin e Menaxhimit.</p>	<p>Agjencia mbështet nismën për shpalljen e Vodno-s një zonë të mbrojtur në kategorinë e zonës së mbrojtur, me indikacione të caktuara.</p> <p>Agjencia mbështeti iniciativën për deklarimin e Vodno-s në kuadër të procedurës për marrjen e një mendimi në lidhje me informacionin mbi nevojën për të shpallur një pjesë të Vodno-s një zonë të mbrojtur në kategorinë e zonës së mbrojtur (02.06.2020) Studimi nuk është lëndë shqyrtimi, por bëhet fjalë për një Projekt-Vendim</p> <p>Projekt-vendimi për shpalljen e një pjese të malit Vodno si zonë e mbrojtur në kategorinë-V zonë e mbrojtur është përgatitur në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Në sistemin juridik të shtetit nuk ka asnjë akt tjetër juridik për shpalljen e zonave të mbrojtura, përveç Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës. Bazuar në këtë ligj, shpallen të gjitha zonat e mbrojtura, përfshirë Vodnon. Neni 1 paragrafi 4 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës përcakton se "Dispozitat e ligjeve të tjera në lidhje me mbrojtjen e natyrës zbatohen gjithashtu për mbrojtjen e natyrës". Në përputhje me nenin 103 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, me qëllim të rregullimit dhe shfrytëzimit të hapësirës së kategorive të zonave të mbrojtura, nëse është e nevojshme, miratohet një Plan Hapësinor. Me</p>

			<p>aktin e shpalljes parashikohet miratimi i Planit hapësinor për Vodnon.</p> <p>Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, nga një subjekt i menaxhimit të zonës së mbrojtur përgatitet një Plan i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur, në këtë rast do të jetë Qyteti i Shkupit. Përmbajtja e planeve për menaxhimin me zonat e mbrojtura përshkruhet në nenin 98 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe aktit nënligjor - Rregullore për përmbajtjen e planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe programet vjetore për mbrojtjen e natyrës (Gazeta Zyrtare e RM nr. 26/12).</p>
11.	Ilir Hasani, person fizik	Mbështetje për procedurën e shpalljes së Vodnos për zonë të mbrojtur	Mbrojtja dhe kujdesi më i detajuar i peizazhit do të rregullohet me Planin e Menaxhimit

12.	Vladimir Lokvenec, Dijana Jankovska, Martin Menkovski dhe Frosina Boshkova	Mbështetja e iniciativës për shpalljen e Vodno-s një zonë e mbrojtur duke treguar se shpallja do të lejojë realizimin e të drejtave dhe ndërtimin e objekteve të strehimit të përkohshëm sipas dokumentacionit të planifikimit	Në Planin e Menaxhimit do të përfshihen aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara sipas zonave në zonën e mbrojtur.
13.	Jordan Savevski, person fizik	Me miratimin e Vendimit për shpalljen e Vodno-s një zonë të mbrojtur, do të relizohet e drejta për mbrojtjen dhe kujdesin e peizazhit.	Me shpalljen e Vodno-s një zonë të mbrojtur, Qyteti i Shkupit do të emërohet si subjekt menaxhues , i cili do të menaxhojë në mënyrë integrale me zonën e mbrojtur. Plani i Menaxhimit do të përmbajë veprime dhe masa për mbrojtjen e peizazhit.
14.	Goran Filipov, person fizik	Mbështetje për shpalljen e Vodno-s për zonë të mbrojtur	Me shpalljen e Vodno-s një zonë të mbrojtur, Qyteti i Shkupit do të emërohet si subjekt menaxhues, i cili do të menaxhojë në mënyrë integrale me zonën e mbrojtur. Plani i Menaxhimit do të përmbajë veprime dhe masa për mbrojtjen e peizazhit

15.	Aleksandar Savevski dhe Maja Savevska	Ata nuk kanë vërejtje dhe tregojnë se kanë investuar në aktivitete të infrastrukturës	Me shpalljen e Vodno-s një zonë të mbrojtur, Qyteti i Shkupit do të emërohet si një subjekt menaxhues, i cili do të menaxhojë në mënyrë integrale me zonën e mbrojtur. Plani i Menaxhimit do të përmbajë veprime dhe masa për mbrojtjen e peizazhit.
16.	Qyteti i Shkupit, Departamenti për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës	<p>Kufiri verior i zonës së mbrojtur të korrigohet dhe të përkojë me kufirin e fushës urbane të qytetit të Shkupit, të përcaktuar nga Plani i Përgjithshëm Urban i qytetit të Shkupit 2012-2022</p> <p>Në Projekt-vendim duhet të përfshihen dispozitat lidhur me masat për mbrojtjen nga erozioni. Masat për mbrojtje nga erozioni gjithashtu duhet të parashikohen në Planin e Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur.</p> <p>Në Projekt-vendim të vendosen dispozita në lidhje me ndalimin për ndërtimin e ndërtesave të reja, zgjerimin dhe</p>	<p>Kufiri verior pothuajse plotësisht përkon me fushëveprimin urban (PPU-së) të qytetit të Shkupit, përveç lëshimeve shumë të vogla për ndjekjen e kufirit natyror ose tjetër logjik dhe të qartë.</p> <p>Vendimi i referohet detyrimit ekzistues për të përcaktuar kufijtë e zonës erozive dhe zonës së rrezikuar nga erozioni në përputhje me rregulloret për ujërat, është vendosur një afat prej 6 muajsh për krijimin e tyre dhe parashikon integrimin e tyre në zonën e mbrojtur.</p> <p>Sipas Rregullores për Planin e Menaxhimit të zonës së mbrojtur, përveç elementëve të tjerë, përcaktohet se masat e mbrojtjes përfshihen për mbrojtjen e peizazhit, diversitetin gjeologjik dhe biologjik, trashëgiminë kulturore, mbrojtjen e zonave karakteristike, si dhe një sistem të masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen nga zjarret dhe fatkeqësitë e tjera natyrore. Deri në miratimin e Planit të Menaxhimit, ndërtimi i ndërtesave të reja, zgjerimi dhe azhurnimi i atyre ekzistuese dhe zgjerimi i fushës urbane të vendbanimeve në territorin e zonës së mbrojtur - Vodno nuk lejohet.</p>

		modernizimin e atyre ekzistuese dhe zgjerimin e fushës urbane të vendbanimeve	
--	--	---	--

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e mendimeve në lidhje me propozimin për shpalljen e një pjese të Vodno-s si një zonë e mbrojtur, mendimet vijuese u dorëzuan në MMJPH:

Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi “ Shkup, Instituti i biologjisë, Fakulteti i shkencave matematiko-natyrore Shkup - jep një mendim pozitiv dhe shprehet se Vodno duhet të shpallet dhe menaxhohet si zonë e mbrojtur sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe nuk ka nevojë të miratohet një Ligj i veçantë për shpalljen e Vodno-s si zonë e mbrojtur.

Shoqata Biologjike Maqedonase - jep një mendim pozitiv dhe beson se Vodno duhet të shpallet zonë e mbrojtur sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, i cili është një ligj sistemik dhe nuk ka nevojë të eksperimentojë me disa Lex Specialis të paqarta dhe thekson se biodiversiteti i Vodno-s mbulon më shumë se 2000 taksonë të florës dhe faunës.

Shoqëria për Mbrojtjen e Natyrës së Maqedonisë - jep një mendim pozitiv dhe mbështet procedurën të cilën e udhëheq MMJPH për shpalljen e një pjese të Vodno-s një zonë të mbrojtur në kategorinë V Zonë e Mbrojtur në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

Shoqata ekologjike maqedonase - jep një mendim pozitiv mbi shpalljen e Vodno-s si zonë e mbrojtur, duke theksuar se rishpallja e suksesshme e Vodno-s si zonë e mbrojtur do të kontribuojë në përmbushjen e dispozitave të Konventës për Diversitetin Biologjik dhe konventave të tjera të ratifikuara në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe direktivat e BE-së për habitatet dhe zogjtë dhe rrjetin Natura 2000 dhe dokumentet strategjike për mbrojtjen e natyrës.

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi” Shkup, Fakulteti i Pylltarisë, Arkitekturës së Peizazhit dhe Eko-Inxhinierisë "Hans M" - paraqiti një mendim negativ përmes Zyrës së Kryeministrit duke theksuar se për Vodnon duhet të miratohet një ligj gjithëpërfshirës në formatin e Lex Specialis duke marrë parasysh aspektet e sigurisë, funksionit të mbrojtjes, shërbimeve të ekosistemit dhe mbrojtjes nga përmbytjet.